



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2440/2 prot,

Datë 06.10.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Inpress*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-75636-07-20-2023, me objekt: “*Blerje Shtypshkrime*”, me fond limit 41.477.281 lekë pa TVSH, zhvilluar më date 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SH.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “*Inpress*” SHPK me NIPT: L52122014L dhe me adresë: *Rruga “Siri Kodra” ish-Blloku i Magazinave Tregtare, Tiranë.*
- Autoriteti Kontraktor:** Posta Shqiptare SH.A  
*Adresa: Rruga “Reshit Çollaku” Nr. 4, Tiranë.*

Në datën 05.10.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3469 dhe me nr. 2440/2023 protokoli, datë 05.10.2023 e operatorit ekonomik “*Inpress*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-75636-07-20-2023, me objekt: “*Blerje Shtypshkrime*”, me fond limit 41.477.281 lekë pa TVSH, zhvilluar më date 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SH.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Inpress*” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*  
*b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;*”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “*Inpress*” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2440 prot., datë 05.10.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

### **Arsyet e skualifikimit:**

*“Operatori Ekonomik “Inpress sh.p.k.”, me NIPT L52122014L dhe me vlerë të ofertës ekonomike 26.817.700 (njëzet e gjashtë milion e tetëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e shtatëqind) lekë pa T.V.SH., i cili nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në tender rezulton që nuk i përmbush kriteret ligjore, ekonomike dhe teknike, pasi:*

*1. “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” i paraqitur në Sistemin Eletronik të APP-së nuk është i njëjtë në formë dhe në përmbajtje me “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit”, Shtojca 8, pjesë e dokumentave standarte të tenderit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Për këtë arsye, konsiderohet se kriteri për dorëzimin e “Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit” parashikuar në germen a, pika 1, të “Kritereve të Veçanta të Kualifikimit” nuk plotësohet. Për më tepër duke qënë se formulari i vendosur nga Operatori Ekonomik në sistem nuk është në analogji me modelin e formularit të parashtruar në brendësi të DST-së pikat 2.3.2; 2.3.3; 2.3.4; 2.3.5 të kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit, nuk janë të pasqyruara dhe si të tilla konsiderohen nga KVO të paplotësuara.*

*2. Referuar “Specifikimeve Teknike” të kërkuara në DST nga Autoriteti Kontraktues rezultojnë këto mangësi:*

*→ Modeli “Mandat Pagese” duhet të jetë 105x140 mm, ndërkohë pas matjeve rezulton të jenë 100x140mm, që janë dhe jashtë tolerancës së lejuar nga AK.*

*• Modeli SP2, Regjistër i Deftesave të Pranimeve të objekteve postare zyrtare, ku në DST përcaktohen përmasat 170x210 mm, pas matjeve konkrete rezulton të jenë 170x200mm, jashtë standarteve perfshirë dhe tolerancën 3% të përcaktuar nga AK.*

*Në zbatim të nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”, rezulton që oferta e mësipërme nuk kualifikohet.”.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 06.10.2023.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**